

VENDIM
Nr. 106, datë 15.2.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.425, DATË 27.6.2012, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË DOKUMENTACIONIT TË
NEVOJSHËM PËR PRANIMIN E PERSONAVE NË INSTITUCIONET REZIDENCIALE,
PUBLIKE DHE JOPUBLIKE, TË PËRKUJDESJES SHOQËRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 20, të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1.3, e kreut I, të vendimit nr.425, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1.3 Mosha e pranueshme për t’u vendosur në shtëpitë e fëmijës është nga 0-18 vjeç, përkatësisht, fëmijët:

- a) nga mosha 0-5 vjeç vendosen në shtëpitë e fëmijës që ofrojnë shërbim të përkujdesjes shoqërore për këtë grupmoshë;
- b) nga mosha 6-15 vjeç vendosen në shtëpitë e fëmijës që ofrojnë shërbim të përkujdesjes shoqërore për këtë grupmoshë;
- c) nga mosha 16-18 vjeç vendosen në shtëpitë e fëmijës që ofrojnë shërbim të përkujdesjes shoqërore për këtë grupmoshë.

2. Riorganizimi i institucioneve të përkujdesjes shoqërore publike, të cilat do të transformojnë shërbimin sipas përcaktimeve në pikën 1, të këtij vendimi, do të realizohet brenda një periudhe 4-mujore nga hyrja në fuqi e tij.

3. Gjatë periudhës së transformimit të institucionit të përkujdesjes shoqërore, strukturat përgjegjëse të shërbimit social shtetëror, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, duhet të garantojnë ofrimin e shërbimit cilësor sipas standardeve për përfituesit në institucione të tjera të përkujdesjes shoqërore, publik ose jopublike, për rastet kur nevojitet mbyllja e shërbimit, por jo për një periudhë më shumë se 4 muaj.

4. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Punëve të Brendshme, ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama